

PROBLEME E DISKUTIME

EMIL LAFE

MBI HABITOREN DHE DISA TRAJTA TË SAJ*

1. Në të gjitha gramatikat e sotme të gjuhës shqipe habitorja njihet si një nga mënyrat e foljes dhe trajtohen katër trajta kohore të saj: e tashmja (*bëkam*), e pakryera (*bëkësha*), e kryera (*paskam bërë*) dhe e kryera e plotë (*paskësha bërë*). K. Cipoja¹ dhe pas tij Sh. Demiraj² flasin edhe për një mënyrë lidhore-habitore, po pa caktuar prerë kohët e saj. Siç dihet, K. Kristoforidhi³ dhe S. Frashëri⁴ në gramatikat e tyre nuk e kanë njohur si mënyrë të veçantë habitoren. As A. Dozoni⁵, i pari autor që ka trajtuar këtë trajtë foljore të veçantë të shqipes dhe ka shpjeguar drejt formimin e saj⁶, nuk i ka njohur trajtat e habitores si një mënyrë të veçantë të foljes (si të tilla ai njihë dëftoren, lidhoren, dëshiroren, urdhëroren dhe pjesoren), por i ka quajtur vetëm «kohë të përbëra admirative» (*temps composés admiratifs*), duke vënë në dukje edhe kuptimin nganjëherë ironik të tyre, çka është lënë pa të drejtë në harresë nga gramatikanët e mëvonshëm. Edhe Pekmezi, duke shkruar në këtë hulli, nuk e njihë habitoren si një mënyrë të veçantë. Këtë qëndrim është munduar ta argumentojë më vonë Simon Shuteriqi⁷, i cili kundërshton me të madhe përfshirjen e habitores e të lidhore-habitores në sistemin e mënyrave të foljes. Duke shkruar pas Samiut, ai pranon vetëm *mote* (trajta kohore) habitore, po kurrësi një mënyrë habitore. Botimi i artikullit të S. Shuteriqit nuk ngjalli ndonjë diskutim rreth kësaj çështjeje dhe trajtat habitore vijuan të trajtohen si një mënyrë e veçantë e foljes.

2. Përveç trajtave të së tashmes (*paskam*), të së pakryerës (*paskësha*), të së kryerës (*paskam pasur*) dhe të më se së kryerës (*paskësha pasur*), Kristoforidhi dhe Samiu kanë në gramatikat e tyre edhe një numër trajtash të tjera habitore, që mungojnë në gramatikat e mëvonshme. Për të bërë

*) Këto shënime të shkurtra mbi habitoren, të hartuara me rastin e «Kolokuiumit albanologjik ndërkombëtar» kushtuar kujtimit të Norbert Joklit, (Insbruk, shtator 1972), botohen këtu me disa ndryshime e plotësime të karakterit redaksional.

1) K. Cipo, «Gramatika shqipe», Tiranë 1949, f. 119.

2) Sh. Demiraj, «Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe» pjesa II, dispensë shtypur nga dega e botimeve e Universitetit, 1961, f. 231 v.

3) K. Kristoforidhi, «Gramatiki tis Alvaniqis Glossis», Kostantinopol 1882.

4) «Shkronjëto e gjuhës së shqip» prej S.H.F. Bukuresht 1882.

5) A. Dozon, «Manuel de la langue chqipe ou albanaise», Paris 1878, f. 225 v.

6) Për historikun e trajtimit të habitores dhe të shpjegimeve që janë dhënë për formimin e saj shih: Sh. Demiraj, *Habitorja dhe mosha e saj* «Studime filologjike», nr. 3, 1971, f. 31-48.

7) S. Shuteriqi, *Mendime e vërejtje rreth gramatikës shqipe* «Buletin i Institutit të Shkencave», nr. 2, 1951, f. 64 vv.

një krahasim ndërmjet këtyre dy gramatikave, po renditim në dy shtylla trajtat habitore të zgjedhimit të foljes *kam*:

Kristoforidhi	Samiu
<i>pasëkam</i>	<i>pasëkam</i>
<i>pasëkesham</i>	<i>pasëkësha</i>
<i>pasëkam pasë</i>	<i>pasëkam pasurë</i>
<i>pasëkesham pasë</i>	<i>pasëkësha pasurë</i>
<i>pasëkam pasë pasë</i>	_____
<i>pasëkesham pasë pasë</i>	_____
<i>të pasëkam</i>	_____
<i>të pasëkeshë</i>	<i>të pasëkësha</i>
<i>të pasëkam pasë</i>	_____
<i>të pasëkeshë pasë</i>	<i>të pasëkësha pasurë</i>
<i>të pasëkam pasë pasë</i>	_____
<i>të pasëkeshë pasë pasë</i>	_____
<i>do të pasëkam</i>	_____
<i>do të pasëkeshë</i>	<i>do të pasëkësha</i>
<i>do të pasëkam pasë</i>	_____
<i>do të pasëkeshë pasë</i>	<i>do të pasëkësha pasurë</i>
<i>do të pasëkam pasë</i>	_____
<i>do të pasëkeshë pasë pasë</i>	_____

Këtu nuk kemi renditur trajtat e paqena dhe të pamundshme *munt të pasëkam (pasë) (pasë)* dhe *munt të pasëkeshë (pasë) (pasë)*, që i ka shpikur Kristoforidhi, duke dashur të fusë në gramatikën shqipe një «mënyrë të mundësisë» (gr. *δυνατική*) «munt të kem», sipas gr. *δύναμαι να έχω*. Siç shihet, Kristoforidhi ka më shumë trajta habitore se Samiu. Së pari, te gramatika e Samiut mungojnë gjashtë trajtat e mbipërbëra *pasëkam pasë pasë, pasëkesham pasë pasë, të pasëkam pasë pasë, të pasëkeshë pasë pasë, do të pasëkam pasë pasë, do të pasëkeshë pasë pasë*. Nga të gjashta këto trajta në kartotekën e gramatikës⁸ të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë ka shembuj vetëm për të parën⁹, por, sipas vëzhgimeve tona edhe e dyta, dëgjohet rrallë e tek në gegërishten (p.sh. *ç'paskësh pasë qenë ai!*). Katër trajtat e tjera nuk dëshmohen e nuk dëgjohen gjëkund dhe s'janë veç krijime të Kristoforidhit, i cili, duke i marrë trajtat habitore si një variant të trajtave të dëftores e të lidhores, për çdo trajtë të këtyre dy mënyrave ka vënë edhe një habitore përgjegjëse, pavarësisht nëse përdorej apo jo një trajtë e tillë.

Samiu ka vepruar në këtë rast në një mënyrë më racionale dhe nuk e ka lejuar veten të tërhiqet nga dëshira për një simetri gramatikore, kur kjo nuk pajtohej me realitetin gjuhësor. Kështu te Samiu mungojnë jo vetëm të gjashtë trajtat e mbipërbëra, që në toskërishten nuk përdoren, por edhe e tashmja e e kryera e lidhore-habitores: *të pasëkam, të pasëkam pasë* dhe e ardhmja e e ardhmja e përparme *do të pasëkam, do të pasëkam*

8) Lënda e kësaj kartoteke është nxjerrë kryesisht nga vjelja e veprave të letërsisë artistike, duke filluar me autorët e Rilindjes e deri në ditët tona, si edhe nga botimet kryesore të folklorit shqiptar.

9) Ja nja dy prej tyre: *U çue plaku: «Të lumtë goja! / sokoleshë paske pasë lé...»*, S. Gera, «Lugina e qetë», Tiranë, 1959, f. 5; *Njeni, tue kërkue për zogjë të rrallë, paska pasë xanëni zog shqypet*. J. Rrota «Rreth votrës» I. Shkodër, 1945, f. 21.

pasë. Të katra këto trajta janë të mundshme, strukturalisht, por e dyta dhe e katërta, siç do ta shtjellojmë më poshtë, nuk përdoren.

Trajta të *pasëkam*, d.m.th. e ashtuquajtura lidhore-habitore e tashme, duket se ka qenë shumë e rrallë në atë kohë. Ajo dhe sot ka një përdorim mjaft të kufizuar¹⁰. Në kartotekën e gramatikës gjenden vetëm katër shembuj me këtë trajtë: *Paska ushqim sa t'dushë Skënerbeu, paska ushqim, sa t'maka ene mushkat me grunë, po ngreu t'hikim!* «Këngë popullore historike», Tiranë 1956 f., 48; *Atëherë i bëmë sytë katër dhe pamë... se ç'pasuri të mirë që mund të përfitoka njeriu...* S. Spasse, «Afërdita», Tiranë, 1944, f. 179; *Gjermani s'dashka të rroka, s'dashka toka!*... A. Abdihoxha, «Një vjeshtë me stuhi», Tiranë 1959, f. 74; *A mund që këtë fat zplot Ta dhënkërka për ju një Zot?* A. S. Pushkin, «Eugjen Onegini», (përkth. i Lasgush Poradecit), Tiranë 1956, f. 60.

3. Dhe tani si qëndron puna e së ardhmes habitore, të cilën pas Kristoforidhit nuk e përmendin më gramatikat? Simon Shuteriqi në artikullin e zënë ngoje, pa e përmendur gramatikën e Kristoforidhit, na kumton se përdoret edhe një trajtë tjetër habitore: *do të shkokam*, për të cilën ai thotë se vjen drejtpërdrejt nga e ardhmja e mënyrës dëftore. Këtë konstatim të S. Shuteriqit e ka përsëdytur prof. M. Domi, duke e cilësuar trajtën në fjalë si të ardhme të habitores: «dëgjohet ndonjëherë edhe një trajtë e së ardhmes së habitores»¹¹. Përdorimin e kësaj trajte e ka vënë në dukje kohët e fundit edhe Sh. Demiraj: «Aty-këtu ndeshen edhe format e së kryerës së dytë (*paska pasë qenë*) dhe të së ardhmes (*do të hapkan*)»¹².


Duke gjykuar sipas lëndës së mbledhur në kartotekën e gramatikës, kjo e ardhme e habitores ka një përdorim më të paktë se trajtat e tjera të kësaj mënyre (e tashmja, e pakryera, e kryera dhe e kryera e plotë). Nga folklori nuk ka dalë ndonjë shembull me këtë trajtë. Ajo shfaqet së pari në letërsinë artistike të këtyre 25-30 vjetëve të fundit dhe ka nisur të shtrihet edhe në stile të tjera të gjuhës letrare. Ja një tok shembujsh që dëshmojnë përdorimin e kësaj trajte:


Oi, edhe mua do [të] më mbake gjë të fshehtë ti, surrat?! A. Abdihoxha, «Një vjeshtë me stuhi», Tiranë 1959, f. 131; Shiko, bir, me zhuka nuk kanë bërë para as njerëz më të zot në tregëti, e do [të] më bëkërke ti, një çunak... J. Xoxa, «Lumi i vdekur» III, Tiranë 1965, f. 41; Më thanë se paskan ardhë për disa punë personale që paskan me kapitenin ingliz, i cili do të ardhka këtu. H. Stërmilli, «Shtigjet e lirisë», Tiranë 1967, f. 83; Thonë se paska ardhur në Korçë dhe nesër do të filloka të grumbulloka qerestenë e gurët për kullën e re. S. Spasse, «Ata nuk ishin vetëm», Tiranë 1952, f. 199; Pa le tani edhe çupat do të shkokan në shkollë! S. Spasse, «Afërdita», Tiranë 1944, f. 18.

10) «Nëpër këngët popullore dhe nëpër veprat e shkrimtarëve tanë hasen kryesisht forma gramatikore të kohës së pakryer dhe të më se së kryerës së kësaj mënyre» (lidhore-habitores). Sh. Demiraj, *Morfologjia...*, f. 231. Sidoqoftë, duke vëzhguar merrgut gjuhën e folur në këta tre vjet që kur hartova së pari këto shënime për habitoren, kam vënë re se e tashmja lidhore-habitore nuk është aq e rrallë sa kisha menduar në fillim.

11) M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, dispensë shtypur nga dega e botimeve e Universitetit, 1961, f. 72.

12) Sh. Demiraj, *Habitorja...*, f. 33.





ryer e kushtores, p.sh. *unë i thashë: «do të vete...»*, — *Unë i thashë se do të veja...* Në rast se ligjërata e drejtë do të përmbante një të ardhme habitore, kjo do të kthehej në atë që Samiu e ka quajtur, siç thamë më lart, «i pritm' i papandehurë», d.m.th. ligjërata «*Ai më tha: «more po do të ardhka drita elektrike edhe në fshatin tonë!»* do të kthehej në: «*Ai më tha se do të ardhkej drita elektrike edhe në fshatin tonë*». Po kështu edhe kallëzuesi i fjalive të tjera kryefjalore e kundrinore, kur tregon një veprim të papandehur, të papritur, duhet të vihet në «të primin e papandehurë», në qoftë se kallëzuesi i fjalisë drejtuese është në të kryerën e thjeshtë a në të pakryerën e dëftores. Kemi gjetur në kartotekën e gramatikës një shembull, në të cilin nga një fjali drejtuese me kallëzuesin në të pakryerën e dëftores varet një fjali kryefjalore me kallëzuesin në habitore, por në të, në vend që të përdorej trajta që Samiu e quan «i pritm' i papandehurë», është përdorur e ardhmja habitore: ... *ky mendim e torturonte më shumë, sepse flitej që tepricën do t'ua ndakan [= do t'ua ndakëshin] fshatarëve të varfër*. S. Spasse, «Afërdita përsëri në fshat», Tiranë 1956, f. 90.

Trajta tjetër «i pritm' i parëpapandehurë» i Samiut ose «kushtorja e së shkuarës» e Pekmezit (*do të paskësja vajtur, do të paskësja hapur*), me sa kemi mundur të ndjekim, nuk dëshmohet gjëkund tjetër veçse në këto gramatika. Megjithatë, kjo trajtë është e mundshme nga pikëpamja e sistemit të gjuhës, sepse më se e kryera lidhore-habitore të *paskësja vajtur*, që qëndron në bazë të saj, ekziston dhe përdoret në gjuhë¹⁷. Por, ashtu si *do të kisha vajtur* lidhet me një *do të kem vajtur* (ato zëvendësojnë njëra-tejtrën kur ndërron plani i marrëdhënieve kohore, njësoj si *do të veja* e *do të vete*), edhe *do të paskësja vajtur* duhet të lidhej me një *do të paskam vajtur*, e cila ndërkaq nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë, sepse nuk ekziston as trajta bazë e saj *të paskam vajtur*, që do të ishte e kryera e lidhore-habitore. Pra, trajta *do të paskësja vajtur* nuk mund të dalë brenda sistemit të trajtave të habitores, duke u ndërruar vetëm plani kohor.

E ashtuquajtura lidhore-habitore, ndryshe nga lidhorja, ka vetëm tri kohë: të tashmen (*të vajtkam*), të pakryerën (*të vajtkësja*) dhe të kryerën e plotë (*të paskësja vajtur*)¹⁸.

Gjithë kjo mund të paraqitet në mënyrë të përmbledhur me anë të kësaj skeme:

17) Ja disa shembuj: — *Hiqmëni këtej se do t'i vë zjarrin!... uluriti, sikur ta paskish përvëluar trualli i kosovarëve*. J. Xoxa, «Lumi i vdekur», II, Tiranë 1965, f. 151; *Tulitet tërë bota e gjallë, sikur të paskej pllakosur hija e mortit*. M. Kuteli, «Xinxifilua», Tiranë 1962, f. 33; *Shazja, sikur ta paske ditur, i turr përpara një përshesh me qumësht*. M. Zaloshnja, «Nën hijen e Tomorit», Tiranë 1961, f. 138. Në shumicën dërmuese të shembujve të mbledhur në kartotekën e gramatikës më se e kryera lidhore-habitore është përdorur në fjali që nisnin me lidhëzën *sikur*.

18) Kristoforidhi ka dhënë trajta habitore për të katër kohët e lidhores: *të pasëkam, të pasëkeshe, të pasëkam pasë, të pasëkeshe pasë*, ndërsa Samiu e ka korrigjuar Kristoforidhin, duke mbajtur vetëm të pakryerën dhe më se të kryerën. Siç thamë më lart, e tashmja atëhere do të ketë qenë mjaft e rrallë, ndërsa e kryera nuk përdoret as sot.

do të vete ————— → *do të vajtkam*

↓
do të veja ————— *do të vajtkështa*
do të kem vajtur

↓
do të kisha vajtur —→ *do të paskështa vajtur*

Kjo duhet kuptuar kështu: trajta *do të vajtkam* është varianti habitor i *do të vete*, trajta *do të vajtkështa* është varianti habitor i *do të veja*, por ajo mund të dalë gjithashtu edhe me rrugë tjetër: në ato rrethana që *do të vete* shndërrohet në *do të veja*, edhe *do të vajtkam* shndërrohet në *do të vajtkështa*. E ardhmja e përparme *do të kem vajtur* nuk ka variant habitor. Kjo lidhet me faktin që sapo përmendëm, se as e kryera e lidhore të *kem vajtur* (mbi bazën e së cilës formohet e ardhmja e përparme) nuk ka variant habitor. Pra, ndryshe nga *do të vajtkështa*, që dilte nga dy burime, trajta *do të paskështa vajtur* mund të dalë vetëm si variant habitor i *do të kisha vajtur*.

Trajtat *do të veja* e *do të kisha vajtur*, siç dihet, kanë nga dy kuptime themelore: kuptimin e mënyrës kushtore dhe kuptimin e një «të ardhmeje të së shkuarës», siç e ka quajtur tani vonë Sh. Demiraj¹⁹ (Sami Frashëri, që veç habitores nuk njeh as kushtoren si mënyrë të veçantë të foljes, i ka futur të dyja këto trajta te mënyra dëftore, duke i quajtur përkatësisht *i pritm' i parthim* dhe *i pritm' i mëparthim*). Më lart shpjeguar se *do të veja* e *do të kisha vajtur*, si të ardhme të së shkuarës, mund të shndërrohen në *do të vajtkështa* e *do të paskështa vajtur*. Po kur këto trajta, d.m.th. *do të veja* e *do të kisha vajtur*, kanë kuptimin e mënyrës kushtore, a mund të transformohen në habitore, d.m.th. a mund të përdoret një *do të vajtkështa* ose *do të paskështa vajtur* në apodosën e një periudhe hipotetike? Deri tani vetëm për trajtën e dytë kam mundur të gjej një shembull: *Po të mos qe [= të mos ishte] kurrizi i kafshës, ku kishte puthitur gjoksin fort, ashtu i thyer përgjysmë në këtë vrapim të marrë, kraharori do t'i paskësh plasur në vend*. J. Xoxa, «Lumi i vdekur» II, Tiranë 1965, f. 98. Por në periudha hipotetike thirrmore e pyetëse, sipas ndjenjës sime gjuhësore, përdorimi i kushtores në trajtë habitoreje, nuk është i pamundshëm. Mua nuk më duket të panatyrshme, të padëgjues kurrë fraza të tilla (si replika dialogësh):

— *Ti kujton se po të mos vinte X. Y. nuk do t'u bëkej kjo punë?*

ose

— *Si do ta paskështa njohur, po të mos ma kishe treguar ti!* Sidoqoftë, për të bërë një pohim më të sigurtë rreth kësaj çështjeje, duhet vëzhguar me kujdes ligjërimi i përditshëm familjar e bisedor, për të parë sa mund të përdoren trajtat në fjalë, pasi në gjuhën e folklorit dhe të letërsisë artistike nuk dalin të gjitha mjetet e sintaksës afektive të këtyre ligjërimeve. Pra, sot për sot nuk mund të pranohet një kushtore në trajtë habitoreje, por më vonë, ndoshta, mund të zhvillohet edhe një kategori e tillë. Kështu që cilësimi nga Pekmezi i trajtave *do të hapkështa* e *do të paskështa hapur* përkatësisht si kushtore e së tashmes e kushtore e së shkuarës dhe përfshirja e tyre në gramatikë me këtë kuptim

19) Sh. Demiraj, «Folja», në «Gramatika e gjuhës së sotme shqipe — morfologjia» (maket), Tiranë 1971, f. 41. S. Shuteriqi (art. cit., f: 64), duke ndjekur Kristoforidhin e Samiun, nuk e pranon fare mënyrën kushtore dhe trajtën *do të shkoja* e quan «i ardhshëm i shkuem» pas gr.

nuk mund të quhet i përligjur, jo vetëm për kohën e autorit, po a për sot.

6. S. Shuteriqi në artikullin e cituar e ka shpjeguar drejt edhe formimin e së ardhmes *do të shkokam*, duke thënë se ajo vjen drejtpërdrej nga e ardhmja e mënyrës dëftore *do të shkoj*. Pra, kjo trajtë nuk duhet shpjeguar si e formuar nga *do + të shkokam*. Vërtet e ardhmja *do të shkoj* vjen nga *do + të shkoj*, duke u formuar kështu një trajtë e një mënyre nga një trajtë e një mënyre tjetër, por në rastin në fjalë puna besoj se ndryshon. Kur në vend të *do të shkoj* duhet thënë *do të shkokam*, kjo bëhet duke marrë trajtën habitore vetë folja që zgjedhohet, pavarësisht nga ekzistenca ose mos ekzistenca e «lidhore-habitores» të *shkokam*. Kjo vërtetohet edhe nga fakti që vumë në dukje më lart se, ndërsa për të ardhmen habitore ka një tok shembujsh, për të tashmen «lidhore-habitore» shembujt janë më të rrallë. Gjithashtu edhe lidhore-habitorja nuk mund të shpjegohet si e formuar nga *të + trajtat* përkatëse habitore (*shkokam, shkokësh, paskësh, shkuar*). Ajo s'është veçse një shtrirje e habitores në mënyrën lidhore, në mos një formim paralel, d.m.th. kur në vend të *të isha* u desh të thuhej *të qenkësh, isha* u shndrua automatikisht në *qenkësh* dhe nuk u formua një *të qenkësh* nga *të + qenkësh*, ashtu siç është formuar *të isha* nga *të + isha*. Pra termi lidhore-habitore tregon jo vetëm se këto trajta kanë karakteristika formale të lidhores e të habitores njëkohësisht, por edhe se, në fund të fundit, këtu kemi të bëjmë me mënyrën lidhore që ka veshur petkun e habitores, për të shprehur kuptimet karakteristike të saj. Në këtë vështrim edhe ajo që quhet thjesht mënyrë habitore *do të ishte më e drejtë të quhej dëftore-habitore*. Aq sa ruhet modaliteti i lidhores të *paskësh*, aq ruhet edhe modaliteti i dëftores të *paskësh*, por ndërsa e para ka edhe pjesëzën të lidhores, e dyta s'ka pasur se ç'të trashëgojë prej dëftores përkatëse (*kisha*). Pra, del se kemi në gramatikën shqipe një mënyrë habitore (që është në të vërtetë dëftore-habitore) dhe një mënyrë lidhore-habitore të cilën K. Cipoja, duke e quajtur me këtë emër, e ka cilësuar shprehimisht si «një mënyrë të re që nuk figuron akoma në gramatikë²⁰. Mendoj se një mënyrë e tillë trajtimi nuk mund të përligjet. Nga ana tjetër të dyja këto «mënyra» nuk mund të mblidhen në një për shkak të modaliteteve të ndryshme të tyre. Habitorja ka modalitetin e dëftores, kurse lidhore-habitorja modalitetin e lidhores. Çdo habitore ose lidhore-habitore mund të zëvendësohet fare mirë nga trajta përkatëse e dëftores ose e lidhores dhe pas këtij operacioni fjalia e ruan modalitetin e saj themelor, p.sh. *Po ti, pse paske zbritur në qytet?* T. Laço, «Ruga e bardhë» Tiranë 1967, f. 56 — *Po ti, pse ke zbritur në qytet?*; *Ata thërrisnin sikur t'u paskësh hyrë dreqi...* S. Godo, «Plaku i Butkës», f. 179. — *Ata thërrisnin sikur t'u kishte hyrë dreqi...* Kjo tregon se këto trajta që zëvendësojnë kaq lehtë njëra-tjetrën nuk mund t'u përkasin dy mënyrave të ndryshme, por s'janë veçse trajta të ndryshme të së njëjtës mënyrë. Kuptimi i habitores është vetëm një kuptim dytësor, i shtuar mbi kuptimin modal themelor që ka trajta foljore përkatëse në mënyrën

20) Vep. cit., f. 119:

dëftore ose lidhore. Kjo është vënë në dukje mjaft qartë edhe nga Sh. Demiraj në maketin e gramatikës së gjuhës shqipe: «me anë të mënyrës habitore shprehet modaliteti i vërtetësisë, i shoqëruar edhe me ndjenjën e habitës së folësit për një veprim të papritur», «si format e së pakryerës, ashtu edhe ato të më se së kryerës (të lidhore-habitores — E. L.) përdoren si sinonime të formave përgjegjëse të mënyrës lidhore»²¹. Por me gjithë këtë konstatim të drejtë, ky autor, ndërsa më një anë pranon një mënyrë habitore, krahas mënyrave të tjera, më anë tjetër lidhore-habitoren e quan «të ashtuquajtur mënyrë», për shkak të përdorimit të kufizuar të trajtave të saj «si në shqipen e folur, ashtu edhe në shqipen letrare»²². Por në gjykimin e kësaj çështjeje, mendoj se ka më shumë rëndësi ana cilësore sesa ana sasiore²³: habitorja, duke u shfaqur në fillim në formë faktesh sporadike të ligjërit, erdhi duke u shtrirë vazhdimisht dhe tashmë e ka hapur vendin e saj në sistemin e gjuhës. Në gjuhën e sotme letrare janë realizuar të gjitha trajtat e mundshme habitore që lejon sistemi (e tashmja, e pakryera, e kryera, e kryera e plotë dhe e ardhmja për dëftoren dhe e tashmja, e pakryera e kryera e plotë për lidhoren), me përjashtim të atyre trajtave që do të ishin një «kushtore-habitore». Rrethana se disa prej tyre përdoren më dendur e disa më rrallë nuk ka rëndësi themelore. Në gjuhë nuk janë të rralla rastet kur fenomene homogjene nga pikëpamja cilësore, kanë dallime të theksuara sasiore në përdorim.

Edhe po ta shikojmë çështjen historikisht, siç kanë vënë re një varg gjuhëtarësh, habitorja ka dalë nga një e kryer e përmbysur, dy gjymtyrët e së cilës janë përngjitur në një fjalë të vetme (*hapkam* < *hap(ur) kam* < *kam hapur*), pra ka origjinë kohore. Njohja e habitores dhe e lidhore-habitores si mënyra më vete ose njohja vetëm e njërës dhe lënia mënjanë e tjetrës, me gjithë volinë praktike që mund të ketë për gramatikën shkollore, nuk mund të vështrohet si një zgjidhje e bazuar, që merr parasysh gjendjen e vërtetë të sendeve. Pas gjithë sa u shtjelluan deri këtu unë besoj se zgjidhja më e drejtë do të ishte që të flisnim për trajta habitore të disa kohëve të mënyrës dëftore, lidhore e eventualisht kushtore dhe jo për mënyra habitore e lidhore-habitore. Sido që të jetë, çështja e trajtuar këtu mendoj se ka nevojë për një studim e diskutim të mëtejshëm, duke u vështruar në kuadrin e krejt sistemit të mënyrave të foljes në gjuhën shqipe.

21) Sh. Demiraj, «Folja» (maket) f. 61, 81.

22) Sh. Demiraj, *po aty*, f. 81.

23) Për sa i takon dendurisë së përdorimit të lidhore-habitores në krahasim me habitoren është me interes të vihet në dukje ky fakt interesant që në veprën e Buzukut, sipas Sh. Demirajt, ndeshen gjithsej 3 forma foljore që për nga struktura mund të interpretohen si forma të habitores përkundrajt 15 rasteve të «së ashtuquajturës lidhore-habitore» (shih «Haborja dhe mosha e saj» f. 41).

